



REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA DIVJAKE

RREGULLORJA

***PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN, DETYRAT DHE KOMPETENCAT E
ADMINISTRATËS SË BASHKISË DIVJAKË***

KAPITULLI I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

NENI 1

Bazueshmëria ligjore dhe qëllimi i rregullores

Kjo rregullore hartohet bazuar në nenin 64 pika “j” e ligjit Nr.139/ 2015 Date 17.12.2015 *“Për Vetëqeverisjen Vendore”*, dhe ka si qëllim rregullimin e marrëdhënieve dhe përcaktimin e detyrave të bashkisë për realizimin e funksioneve dhe kompetencave të saj.

NENI 2

Objektivat e Rregullores

Kjo rregullore hartohet bazuar në ligjin Nr.139/ 2015 date 17.12.2015 *“ Për Vetëqeverisjen Vendore ”* dhe ka si qëllim :

- Të krijojë një kuadër rregullator për të realizuar funksionimin me efikasitet të administratës së Bashkisë së Divjakës, për realizimin e funksioneve publike të saj;
- Të disiplinojë aktivitetin e bashkisë për realizimin e detyrave funksionale dhe kompetencave të saj;
- Të krijojë kushte për veprimtari transparente të administratës së bashkisë ndaj publikut dhe organeve shtetërore;
- Të krijojë një instrument për ndarjen e detyrave, në varësi të strukturës së Bashkisë;
- Të përcaktojë rregullat e bashkëpunimit ndërmjet strukturave të ndryshme të Bashkisë.

NENI 3

Përshkrimi i termave

Për efekt të kësaj rregulloreje termat e përdorur kanë kuptimin si më poshtë:

Administrimi : Është e drejta për të planifikuar , financuar , organizuar ushtrimin e një funksioni .

Administrata e Bashkisë së Divjakës: kryetari, zv/kryetari, sekretari i përgjithshëm , drejtuesit e drejtorive, Përgjegjësit e zyrave, specialistët dhe punonjësit e tjerë.

Akt: Çdo vendim, urdhër, urdhëresë, kontratë, rezolutë apo disponim tjetër, i cili ka efektin e të mësipërmeve që ka lidhje me zbatimin e kompetencës për realizimin e funksioneve publike të Bashkisë Divjakë, i nxjerrë nga organet kompetente, sipas procedurave e standardeve të përcaktuara me ligj.

Administrimi : Është e drejta për të planifikuar , për të financuar dhe për të organizuar ushtrimin e një funksioni të caktuar .

Funksion: Fusha e veprimtarisë së bashkisë, për të cilën ajo është përgjegjëse për administrimin, financimin, rregullimin etj., dhënë me ligj.

Kompetencë: Autoriteti i bashkisë i dhënë me ligj për realizimin e funksioneve të veta, të përbashkëta e të deleguara.

Buxhet: Programi vjetor financiar në të cilin përfshihen granti, të ardhurat, shpenzimet dhe investimet e bashkisë për realizimin e funksioneve të saj publike.

Epror direkt: Është kryetari i bashkisë për zv/kryetarin, drejtorët e drejtorive, sektorët dhe drejtuesit e institucioneve vartëse. Në mungesë të kryetarit eprori direkt është zv/kryetari, për të gjitha drejtoritë, zyrat dhe institucionet vartëse.

KREU II

ORGANIZIMI DHE DISA RREGULLA TË PËRGJITHSHME, TË PUNËS NË ADMINISTRATËN E BASHKISË

NENI 4

- Bashkia ushtron funksione, kompetenca , si dhe funksione të deleguara .
- Funksionet që i njihen Bashkisë janë të përcaktuara në ligjin nr.139/ 2015 Për Vetëqeverisjen Vendore . Funksione apo kompetenca të tjera mund ti njihen vetëm në bazë të ligjit .
- Funksionet e deleguara u transferohen Bashkisë me ligj ose me marrëveshje
- Në cdo rast delegimi i funksioneve shoqërohet nga transferta e mjaftueshme e Bashkisë për të financuar koston e ushtrimit të këtyre funksioneve .

NENI 5

Parimet bazë në ushtrimin e funksioneve

- Bashkia e rregullon dhe administron ushtrimin e funksioneve të saaj në mënyrë të plotë dhe të pavarur , në përputhje me Kushtetutën , Kartën Europiane të Autonomisë Vendore si edhe në përputhje me ligjet në fuqi . Bashkia i ushtron funksionet duke respektuar politikat kombëtare dhe ato rajonale . Për këto funksione , qeverisja qendrore mund të vendosë standarde e norma specifike të përgjithëshme , me qëllim ruajtjen e interesave kombëtare si edhe ofrimin e shërbimeve cilësore .
- Në rastet kur Bashkia nuk zotëron fondet ose mjetet e mjaftueshme për arritjen e standardeve dhe normave kombëtare , qeverisja qendrore jep

mbështetjen e nevojshme financiare .

- Bashkia administron ushtrimin e funksioneve të deleguara sipas legjislacionit në fuqi .
- Qeverisja qëndrore në ushtrimin e funksioneve të deleguara nga Bashkia i siguron mjetet dhe burimet financiare të nevojshme për të ushtruar këto funksione në mënyrën dhe në atë nivel ose standard , i cili është përcaktuar me ligj .

NENI 6

Administrata e Bashkisë Divjakë drejtohet nga Kryetari i Bashkisë, i ndihmuar nga Zëvendëskryetarët.

NENI 7

Administrata e bashkisë është e organizuar në drejtori , sektor dhe zyra.

NENI 8

Drejtoritë janë njësi bazë të strukturës organizative të Bashkisë Divjakë dhe përgjigjen për një ose disa elemente (detyra) të një fushe të caktuar.

NENI 9

Zyrat përgjigjen për aspekte të veçanta të këtyre elementeve (detyrave).

NENI 10

Struktura organizative, emërtimet, dhe kërkesat për kualifikimin e tyre miratohen nga Kryetari i Bashkisë, numri i personelit të Bashkisë miratohen nga Këshilli i Bashkisë.

NENI 11

Të gjitha strukturat dhe nëpunësit në administratën e bashkisë së çdo niveli punojnë kryesisht me plane pune mujore dhe vjetore. Të gjitha planet dhe programet e punës në bashki miratohen nga kryetari bashkisë, zv/kryetarët, ose/dhe sipas shkallës së hierarkisë.

NENI 12

Simbolet

- Kryetari i Bashkisë në raste pritjesh zyrtare, festash a ceremonish vendos shiritin e kryetarit (i cili vendoset, duke u mbështetur në supin e djathtë).
- Bashkia Divjakë ka stemën e saj të miratuar nga Këshilli Bashkiak.
- Flamuri i bashkisë detyrimisht ekspozohet në hyrje të aparatit;
- Së bashku me flamurin e bashkisë vendoset edhe flamuri kombëtar.
- Flamuri kombëtar ekspozohet edhe në sheshin kryesor të qytetit;
- Në ngritjen dhe uljen e flamurit kombëtar aplikohen me rigorozitet udhëzimet përkatëse.
- Stema e bashkisë e derdhur në plastike përdoret detyrimisht në uniformën e

Policisë Bashkiake.

- Emblema e Bashkisë Divjakë mbahet në zyrën e kryetarit. Kopje të saj jepen si dhuratë në raste shkëmbime vizitash etj.

NENI 13

Përdorimi i vulës

- Bashkia Divjakë ka një vulë zyrtare, e cila identifikon institucionin në dokumentet e nxjerra prej saj, si dhe vula të tjera sipas përcaktimeve specifike në aktet ligjore dhe nënligjore, si: vula e sekretarisë, vula e inspektoriatit veterinar, si dhe vula e gjendjes civile;
- Vula e bashkisë mbahet dhe përdoret nga punonjësi i protokollit;
- Vula ruhet në kasafortë dhe përdoret vetëm nga punonjësi i caktuar për këtë qëllim. Në rast mungese të tij për periudha të caktuara kohe, Kryetari i Bashkisë me urdhër të brendshëm ngarkon specialistin e arkivit që të mbajë dhe përdorë vulën e institucionit;
- Vula përdoret për dokumente që kanë datë dhe numër protokollit dhe janë të firmosura nga Kryetari i Bashkisë apo personi i autorizuar prej tij.

NENI 14

Praktika shkresore

Është tregues me rëndësi në punën e institucionit, e cila tregon nivelin kulturor, profesional e përgjegjësitë e punonjësit të aparatit.

- Në konceptimin e një shkrese duhet të merren parasysh:
- Si rregull, me parë konceptohet paraprakisht problemi që do të parashtrohet;
- Shkresat zyrtare shkruhen saktë, kuptueshëm dhe thjesht;
- Moduli i shkresës dhe normat e paraqitjes së një shkrese miratohen nga Kryetari i Bashkisë me urdhër të veçantë dhe janë të detyruar ta zbatojnë të gjithë punonjësit e administratës;
- Në të gjitha rastet në krye të shkresës vendoset stema e Bashkisë Divjakë.
- Zyra e protokollit nuk lejon kalimin e shkresave që nuk plotësojnë standardin e miratuar nga Kryetari i Bashkisë;
- Në kopjen e dytë të shkresës (shkresa që do të arkivohet) vihet emri i konceptuesit.
- Për shkresat, të cilat dalin jashtë aparatit dhe iu adresohen institucioneve vendore apo qendrore, duhet përdorur modulari tip, i cili përmban emblemën e bashkisë, adresën e institucionit, numrin e telefonit të kontaktit, numrin e faksit, ëbsite dhe email-in e Bashkisë Divjakë .

NENI 15

E drejta e firmës mbi aktet dhe shkresat që dalin nga institucioni

- I gjithë dokumentacioni shkresor, aktet (vendime, urdhra, udhëzime), korrespondenca (shkresat) për përdorim të brendshëm apo që destinohen për jashtë aparatit nënshkruhen nga Kryetari i Bashkisë;
- Në rastet kur Kryetari i Bashkisë mungon, shkresat firmosen nga personi i ngarkuar prej tij (si rregull nga Zv/Kryetari i Bashkisë), me shenimin “**në**

mungesë dhe me urdhër”.

- Në mungesë të Kryetarit dhe me porosi të tij, shkresat përcjellesë të akteve, materialeve informuese etj., firmosën nga Zv/Kryetari.
- Shkresat që qarkullojnë brënda aparatit të bashkisë firmosen nga drejtori i drejtorisë ose përgjegjësi i zyrës, i cili koncepton shkresën dhe më pas ciklohen nga Kryetari Bashkisë.
- Kryetari autorizon firmën e dytë, e cila do të depozitohet pranë institucioneve financiare;
- Si rregull, drejtoritë, përgjegjësit e sektorëve , zyrat firmosin shkresat në kompetencë të tyre, iu përgjigjen ankesë-kërkesave, si dhe shkresave të adresuara direkt nga sektorët e tyre në institucione etj. Ato firmosin shkresa zyrtare edhe në raste të tjera, me autorizim të Kryetarit;
- Detyrimisht evidencat që përmbajnë të dhëna firmosen nga personi që i ka hartuar ato, ndërsa shkresa përcjellëse firmoset nga Kryetari i Bashkisë, apo personi i autorizuar prej tij;

NENI 16

Qarkullimi i korrespondencës zyrtare brënda administratës

- Korrespondenca merret çdo ditë në dorëzim nga zyra e protokollit, e cila përgatit dosjen për Kryetarin e Bashkisë;
- Kryetari pasi njihet me praktikën e korrespondencës ua shpërndan për ndjekje e kompetenca personave që ai ngarkon;
- Lëvizja e korrespondencës brenda aparatit bëhet kundrejt firmës;
- Me përfundimin e praktikës (brenda 40 diteve) shkresa kthehet përsëri në

zyrën e administrates;

- Detyrimisht praktika vjetore, pra dorëzimi i të gjitha shkresave të administratës në arshivë, përfundon brenda datës 25 dhjetor;
- Në të gjithë punën me shkresat dhe korrespondencën ruhet sekreti shtetëror;
- Dokumentacioni i tenderit dorëzohet me inventar në arkivë pas nënshkrimit të kontratës dhe jo më vonë së 5 (pesë) ditë nga përfundimi i plotë i praktikës së tenderit;
- Dorëzimi bëhet me inventar konform ligjit e rregullores së arkivit.

NENI 17

Dokumentacioni dhe pajisjet

- E gjithë veprimtaria që do të zhvillohet në institucion evidentohet me studime, analiza, kontrole, raporte, informacione, plane veprimi të përbashkëta ose çdo formë tjetër e dokumentuar;
- Çdo specialist jep informacion periodik për punën që bën. Ai merr pjesë në analizat vjetore ose periodike të sektorit a të zyrës, si dhe ato që zhvillohen në shkallë institucioni;
- Asnjë nëpunës nuk ka të drejtë dhe nuk mund të mbajë dokumente, harta, dosje me të dhëna, pajisje e mjete të tjera pune jashtë aparatit të bashkisë pa lejen e titullarit të bashkisë;
- Dorëzimi ose marrja e detyrës bëhet brenda afateve të përcaktuara në vendimin e titullarit të bashkisë, me procesverbal të rregull dhe inventarin e zyrës së materialeve që disponon sektori. Një kopje e procesverbalit

dorëzohet në administratë tek shefi i sektorit të Burimeve Njerëzore. Në këto raste respektohen të gjitha kërkesat dhe parametrat e legjislacionit në fuqi si: Ligji nr. 6942, datë 15.12.1984 “ *Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin e qarkullimin e vlerave monetare e materiale* ”, VKM nr. 70, datë 11.03.1985 “ *Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin e qarkullimin e vlerave monetare e materiale* ”.

- Të gjithë nëpunësit dhe punonjësit e aparatit kujdesen për mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrës. Për çdo dëmtim të shkaktuar nga ana e tyre ata përgjigjen materialisht. Fleta e inventarit afishohet në ambientin e zyrës.

KREU IV

FUNKSIONIMI I ADMINISTRATËS SË BASHKISË

NENI 18

Marrëdhëniet me Këshillin Bashkiak

- Marrëdhëniet e administratës së bashkisë me këshillin bashkiak mbahen dhe realizohen kryesisht nëpërmjet kryetarit të bashkisë, i cili merr masat e duhura për zbatimin e vendimeve të këshillit bashkiak, si dhe relaton e informon këshillin dhe komisionet e tij, për ecurinë e aktivitetit të bashkisë dhe problemet e dala.
- Kryetari dhe nëpunësit e bashkisë janë të detyruara të informojnë këshilltarët, nëse u kërkohet për të gjitha problemet e juridiksionit të bashkisë dhe ju vohet në dispozicion çdo lloj dokumenti për njohjen e këtyre problemeve me përjashtim të atyre dokumentave që dispozitat ligjore për

konfidencialitetin e ndalojnë një gjë të tillë. Kërkesa i bëhet kryetarit të bashkisë i cili autorizon personat përkatës për plotësimin e saj.

- Për realizimin e funksioneve të bashkisë që janë kompetencë e këshillit, cdo drejtori, dhe cdo sektorë sipas fushave përkatëse, përgatit materialin përkatës i cili, pasi konfirmohet nga kryetari i bashkisë i paraqitet këshillit për miratim.
- Materiali përgatitet në formën e një projekt-vendimi dhe i shoqëruar me relacionin shpjegues përkatës. Para përgatitjes në këshill, relacioni firmoset nga nëpunësi që e ka përgatitur dhe drejtori i drejtorisë përkatës, ndërsa projekt-vendimi, përveç tyre, ciklohet edhe nga juristi dhe sekretari i këshillit bashkiak. Në relacion jepen shpjegime për motivet e nxjerrjes së aktit, bazueshmërinë ligjore të tij, detyrimet financiare në se ka, procedurat paraprake të ndjekura deri në propozimin e aktit etj.
- Çdo drejtues drejtorie apo nëpunës është i detyruar të marrë pjesë në mbledhjet e këshillit bashkiak, kur kjo kërkohet nga këshilli dhe kur diskutohet dhe shqyrtohen materiale dhe çështje të drejtorisë së tij: materiali në këshill relatohet nga drejtori i drejtorisë përkatëse që e ka paraqitur dhe çdo drejtues a nëpunës tjetër është i detyruar të jap shpjegime rreth tij, nëse i kërkohet nga këshilltarët

NENI 19

Marrëdhëniet me institucionet e tjera

- Marrëdhëniet me institucionet e tjera mbahen nëpërmjet kryetarit të bashkisë. Marrëdhëniet realizohen nëpërmjet takimeve, grupeve të punës,

studimeve, analizave, projekteve, konferencave, shkëmbimit të informacionit dhe eksperjencave.

- Çdo drejtor drejtorie apo nëpunës është i detyruar t'i përgjigjet me kopetencë dhe në kohë kërkesave të institucioneve të ndryshme si ato qendrore dhe atyre vendore, për probleme të fushave përkatëse, sipas përcaktimit dhe delegimit të bërë nga kryetari. Korrespondenca me këto institucione, në raste të tilla, miratohet dhe firmoset nga kryetari i bashkisë apo titullare të tjerë të autorizuar prej tij.
- Kërkesat ndaj institucioneve të tjera, miratohen dhe firmosen nga kryetari i bashkisë apo titullarë të tjerë të autorizuar prej tij.
- Për çdo korrespondencë me institucionet e tjera për probleme të caktuara, çdo drejtori përgatit praktikën përkatëse të sistemuara në dosje të vecantë, e cila në përfundim arshivohet në arkivë sipas rregullave të saj. Pas përfundimit të çdo praktike, personi përgjegjës që e ka projektuar, bënë në të shënimet përkatëse për trajtimin dhe mënyren e përfundimit të saj.

NENI 20

Bashkëpunimi me njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore

Bashkia në kryerjen e funksioneve të saja si edhe në ofrimin e shërbimeve

specifike mund të ushtrojë së bashku me një apo disa Bashki të tjera cdo funksion dhe shërbim të dhënë me ligj , nëpërmjet lidhjes dhe zbatimit të marrëveshjeve ose kontratave të përbashkëta , delegimit të kompetencave dhe përgjegjësi të vecanta njëra – tjetrës ose kontraktimit me një palë të tretë . Gjithashtu Bashkia mund të lidh marrëveshje bashkëpunimi ndërvendor me njësi të vetëqeverisjes vendore të shteteve të huaja .

NENI 21

Marrëdhëniet me Publikun

- Marrëdhëniet me publikun realizohet në përputhje me kodin e procedurave administrative, ligjin për informimin publik, ligjin për etikën e nëpunësve civil, si dhe zakoneve të mira si për sa i përket ankesave apo kërkesave të qytetarëve, ashtu edhe marrëdhënieve të tjera me ta apo me ente të ndryshme private.
- Çdo drejtues drejtorie apo nëpunës, është i detyruar t'i përgjigjet me kompetencë, profesionalizëm dhe në kohë kërkesave dhe ankesave të qytetarëve që i drejtohen direkt atij ose i delegohen nga titullarët e bashkisë. Afati për dhënien e përgjigjes kërkesave apo ankesave të qytetarëve është 40 ditë nga dita e paraqitjes së saj.
- Kryetari i Bashkisë bën pritje me popullin një herë në javë. Zv/kryetarët bëjnë pritje cdo ditë nga ora 14.00 deri në orën 16.00. Drejtorit dhe zyrat bëjnë pritje cdo ditë nga ora 12.00 deri në orën 16.00.

NENI 22

Kërkesat dhe ankesat

- Kërkesat dhe ankesat me shkrim dhe me gojë paraqiten në sektorin e informacionit dhe marrëdhëjeve me publikun të bashkisë. Kryetari i bashkisë përcakton strukturat përkatëse që do të merren me trajtimin e tyre. Trajtimi i të gjithë kërkesave dhe ankesave do të bëhet sipas procedurave të përcaktuara në kodin e procedurave administrative.
- Cdo përgjigje e shkruar dhene kërkesave apo ankesave të qytetarëve do të firmoset nga kryetari i bashkisë apo personi i autorizuar, pasi të jetë firmosur nga personi që e ka përgatitur dhe drejtuesi i drejtorisë përkatëse.
- Nepunësi i zyrës së marrëdhëjeve me publikun, pasi degjon kërkesën, plotëson formularin përkatës dhe i dërgon atë tek protokollin për tu protokolluar dhe futet në dosjen e korrespondencës për t'u cikluar te Kryetari i Bashkisë.

NENI 23

Vizitoret

Vizitoret do të lejohen të hyjnë nëpër zyrë, vetëm pasi nepunësi i zyrës së pritjes të ketë komunikuar dhe të ketë marrë miratimin nga nepunësi që pret vizitën.

Ne cdo rast, vizitori pajiset me nje fletë-hyrje ku sherben zyra që e pret dhe kohëzgjatja e vizitës. Me përfundimin e pritjes, kjo flet-hyrje i dorëzohet nëpunësit të zyrës së marrëdhënieve me publikun.

NENI 24

Afishimi i aketeve juridike

Në pika të ndryshme të qytetit, bashkia vendos stenda për informimin e publikut. Në këto stenda si edhe ne faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Divjakë afishohen detyrimisht të gjitha vendimet dhe urdhëresat e këshillit bashkiak, vendimet e urdhëresat e kryetarit të bashkisë, si dhe vendimet për afishim nga institucionet e tjera . Kryetari i Bashkisë nëpërmjet caktimit të një nëpunësi si koordinatori i transparencës miraton programin e transparencës , duke siguruar akses nga të gjithë shtresat e komunitetit në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për të drejtën e informimit .

NENI 25

Seancat e këshillimit

- Për probleme që kanë të bëjnë me administrimin e pronave bashkiake, politikat fiskale të bashkisë, hartimin e buxhetit, ndryshimin e kufijve administrative, bashkia zhvillon seanca degjimi dhe keshillimi me bordet qytetare, por kjo mund të zbatohet edhe për probleme të tjera me rëndësi për komunitetin.
- Seancat e degjimit apo te keshillimit zhvillohen me komunitetin në përgjithësi me grupe të vecanta të interesit, si dhe specialistë të fushave

përkatëse.

- Në varësi të problematikës, seancat e këshillimit mund të shihen edhe në zona të vecanta të territorit nën juridiksionin e bashkisë.
- Për të organizuar seancat e dëgjimit apo këshillimit, bashkia bënë njoftime publike në mediat lokale dhe në standat e informacionit të saj. Në raste të caktuara bashkia bën ftesa të vecanta për individë të ndryshëm apo grupe të caktuara të interesit për pjesëmarrjen në këto seanca.
- Kryetari i bashkisë përcakton kohën dhe vendin ku do të zhvillohen seancat e këshillimit të cilat mund të zhvillohen në ambientet e bashkisë apo në ambiente të tjera publike.
- Në këto seance përvec Kryetarit të Bashkisë marrin pjesë dhe drejtorët e drejtorive, anëtarët e komisioneve përkatëse të këshillit bashkiak etj.
- Në seancat e këshillimit apo dëgjimit, çështja që do të diskutohet paraqitet tek kryetari i bashkisë ose personi i caktuar prej tij.
- Në këto seanca mbahet protokoll i vecantë, në të cilin shënohen të gjitha mendimet, diskutimet, propozimet dhe sygjerimet e ndryshme.
- Propozimet, sygjerimet dhe diskutimet e bëra nga publiku në rastet e dëgjimit apo këshillimit, janë orientuese dhe këshilluese për procesin e vendimmarrjes për çështjen që diskutohet.

NENI 26

Drejtori i drejtorisë

- Mbështetur në këtë rregullore harton politika zhvillimi dhe përshkrimin e punës për funksionet që mbulon.
- Në zbatim të detyrave që rrjedhin nga planet strategjike, programet vjetore dhe periodike të miratuara në shkallë institucioni (bashkie) parashikon në planet e punës mujore të gjitha detyrat që i dalin drejtorisë sipas fushave përkatëse. Ndjek sistematikisht plotësimin e tyre dhe çdo muaj bën analizën në nivel drejtorie.
- Drejtori i drejtorisë bën shpërndarjen e korrespondencës që i adresohet drejtorisë tek specialistët dhe ndjek e kontrollon punën që bëhet nga sektorë apo specialistë të veçantë për përcaktimin e dhënien e zgjidhjeve ligjore në afatet e caktuara.
- Kontrollon dhe firmos gjithë korrespondencën që përgatisin punonjësit e drejtorisë.
- Harton projekt-akte ligjore për veprimtarinë që mbulon drejtorinë, i paraqet dhe bën mbrojtjen e tyre gjatë diskutimit deri në miratim në Këshillin e Bashkisë dhe strukturat e tij (komisionet e Këshillit).
- Merr pjesë në mbledhjet e Këshillit të Bashkisë, duke qenë i gatshëm për të dhënë shpjegimet e nevojshme në lidhje me materialet e përfshira në rendin e ditës së seancës plenare të Këshillit, apo për probleme që lidhen me problematikën që mbulon drejtorinë përkatëse.
- Plani mujor i punës përgatitet nga përgjegjësit e sektorëve dhe çdo specialist, në 2 (dy) kopje, nënshkruhet prej tyre dhe miratohet nga drejtori.
- Plani mujor i punës së drejtorive, sipas pikës së mësipërme hartohet për

muajin pasardhës dhe dorëzohet tek Nenkryetari , për t'ia kaluar për miratim Kryetarit të Bashkisë brenda datës 5 të muajit.

- Plani mujor i punës duhet të përmbajë objektiva konkrete me parametra të matshëm, shoqëruar me afate të caktuara dhe personat përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e tyre.
- Deri në datën 28 të çdo muaji drejtorët e drejtorive dhe drejtuesit e institucioneve vartëse përgatisin në 2 (dy) kopje, nënshkruar prej tyre, analizën mbi realizimin e objektivave të punës të planifikuara për muajin paraardhës dhe i diskutojnë ato në takimin periodik që organizon Kryetari me drejtorët.
- Drejtorët e drejtorive, dhe përgjegjësit e sektoreve përgatisin edhe informacione të tjera, joperiodike, për probleme të caktuara apo me kërkesë të Kryetarit të Bashkisë.
- Drejtorët e drejtorive dhe përgjegjësit e sektoreve bëjnë vlerësime periodike (vjetore) pune për punonjësit që ka në vartësi.

NENI 27

Shefi i sektorit

- Përgjigjet para titullarit të bashkisë, për shkallën e plotësimit të detyrave të ngarkuara prej tij nga punonjësit që punojnë në zyrë;
- Merr masa organizative për plotësimin e detyrave nga çdo punonjës në veçanti dhe si sektor brenda planifikimit të detyrave të drejtorisë.
- Evidenton probleme që dalin nga veprimtaria e përditshme, si shqetësimet e ndryshme që ngrihen me shkrim nga qytetarët, si edhe përcakton zgjidhjet e

mundshme brenda kuadrit ligjor në fuqi.

- Kontrollon punën e përditshme të specialistëve në varësi për plotësimin e detyrave që i janë ngarkuar;
- Kryen studime për fusha të ndryshme dhe organizon sistemin e informacionit për sektorin që mbulon;
- Merr pjesë në mbledhjet e Këshillit të Bashkisë, duke qenë i gatshëm për të dhënë shpjegimet e nevojshme në lidhje me materialet e përfshira në rendin e ditës së seancës plenare të Këshillit, apo për probleme që lidhen me problematikën që mbulon zyrën përkatëse.
- Plani mujor i punës përgatitet nga përgjegjësit e zyrave dhe çdo specialist, në 2 (dy) kopje dhe dorëzohet tek nenkryetari , për t’ia kaluar për miratim Kryetarit të Bashkisë brenda datës 5 të muajit.
- Plani mujor i punës duhet të përmbajë objektiva konkrete me parametra të matshëm, shoqëruar me afate të caktuara dhe personat përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e tyre.
- Deri në datën 30 të çdo muaji përgjegjësit e zyrave përgatisin analizën mbi realizimin e objektivave të punës të planifikuara për muajin paraardhës dhe i diskutojnë ato në takimin periodik që organizon Kryetari me drejtorët dhe shefat e zyrave.
- Përgatisin edhe informacione të tjera, joperiodike, për probleme të caktuara apo me kërkesë të Kryetarit të Bashkisë.
- Bëjnë vlerësime periodike (vjetore) pune për punonjësit që ka në vartësi.

NENI 28

Specialisti

- Zbaton me përpikmëri dhe në nivel të lartë profesional të gjitha detyrat e ngarkuara nga eprori;
- Jep përgjigje ligjore dhe teknike për problemet që mbulon sipas detyrave që i ngarkohen brenda sektorit;
- Ndjek korrespondencën që i është dhënë për trajtim nga eprori, maksimumi brenda 20 ditëve nga afati i marrjes së detyres; përgatitë materialin dhe pasi e siglon ia paraqet përgjegjësit ose drejtorit të drejtorisë për miratim e konfirmim.
- Specialisti mban përgjegjësi për cilësinë profesionale të materialeve të përgatitura;
- Si gjithë nëpunësit kanë për detyrë të punojnë në vazhdimësi për rritjen e aftësive të tij tekniko-profesionale, në funksion të plotësimit sa më të mirë të detyrës së ngarkuar.

KREU V

KOMPETENCAT DHE DETYRAT E ADMINISTRATËS

SË BASHKISË

NENI 29

Kryetari i Bashkisë

a. Në zbatim të ligjit Nr.139/2015, date 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, neni 64, Kryetari i Bashkisë, nëpërmjet urdhërave dhe vendimeve, organizon dhe drejton punën e administratës për kryerjen e funksioneve të Bashkisë.

b. Kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë:

- Ushtron të gjitha kompetencat ligjore në kryerjen e funksioneve të Bashkisë, me përjashtim të atyre që janë kompetencë vetëm e Këshillit përkatës;
- Zbaton aktet e Këshillit të Bashkisë;
- Merr masa për përgatitjen e materialeve të mbledhjeve për Këshillin Bashkiak në përputhje me rendin e ditës të përcaktuar nga Këshilli, si dhe për probleme që kërkon ai vetë;
- Raporton në Këshill për gjendjen ekonomiko-financiare të bashkisë dhe njësive administrative përbërëse të paktën çdo 6 muaj ose sa herë kërkohet nga Këshilli;
- Raporton para Këshillit, sa herë kërkohet prej tij, për probleme të tjera që kanë të bëjnë me funksionet e Bashkisë;
- Është anëtar i Këshillit të Qarkut;
- Emëron duke respektuar ligjin për barazinë gjinore , zëvendëskryetarin / zëvendëskryetarët e bashkisë dhe i shkarkon ato .
- Vendos për emërimin ose shkarkimin e anëtarëve të organeve drejtuese të

shoqërive tregtare në pronësi të bashkisë , si dhe drejtuesit e ndërmarrjeve e të institucioneve në varësi ;

- Emëron dhe shkarkon punonjësit e tjerë të strukturave dhe njësive në varësi të bashkisë , përvec kur parashikohet ndryshe në ligjin për nënpunësin civil .
- Ushtron të drejtat dhe siguron plotësimin e të gjitha detyrimeve që i janë ngarkuar Bashkisë si person juridik dhe është përfaqësues I saj në marrëdhënie me të tretët ;
- Merr masa për kualifikimin dhe trajnimin e personelit të administratës, të institucioneve arsimore, sociale, kulturore e sportive;
- Kthen për rishqyrtim jo më shumë se një herë në Këshill vendime, kur vëren se ato çënojnë interesa të bashkësisë. Në rastin e kthimit të vendimit të këshillit nga kryetari i bashkisë , këshilli mund të miratojë të njëjtin vendim vetëm me shumicën e votave , në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve ;
- miraton strukturën , organikën e kategoritë , klasat e pagave për cdo pozicion të shërbimit civil dhe rregulloret bazë të administratës së bashkisë dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë , në përputhje me legjislacionin në fuqi ;
- emëron dhe shkarkon nënpunësit vendorë për barazinë gjinore ;
- kujdeset për mbledhjen dhe përpunimin e statistikave vendore , të ndara sipas gjinisë , dhe siguron publikimin e tyre ;

NENI 30

Nënkryetari i Bashkisë

Rregullorja e funksionimit të Bashkisë Divjake

a. Në struktura e saj Bashkia e Divjakës ka dy Nënkyetarë të cilët emërohen dhe shkarkohen nga Kryetari i Bashkisë në bazë të nenit 64 të ligjit Nr.139/2015 date 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”.

b. Detyrat e Nënkyetarit të Bashkisë:

- Zëvendëson Kryetarin kur ai largohet për periudha të ndryshme kohe të shkurtër si : leje të zakonshme, vizita për punë apo private jashtë shtetit, sëmundje të ndryshme;
- Zëvendëson kryetarin duke kryer të gjitha detyrat e tij (sipas Ligjit) kur ky largohet për periudha më shumë se një muaj;
- Kryeson komisione të ndryshme sipas kompetencës që jep kryetari;
- Firmos shkresa dhe dokumenta që i delegon kryetari “ me dhe pa porosinë e tij:
- Ndjek probleme të përgjithshme të administratës, drejtorive apo struktura të tjera sipas delegimit që i bënë kryetari;
- Merr pjesë në takimet dhe bisedat sipas protokolleve që përcaktohen nga Kryetari i Bashkisë;
- Bënë pritje të popullit bashkë me departamentet, merr dhe jep përgjigje për kërkesat dhe ankesat e qytetarëve;
- Ndjek dhënien e përgjigjeve të shkresave të qytetarëve për Drejtoritë në varësi apo struktura të tjera;
- Komunikon për probleme operative të funksionimit të administratës, jep urdhëra dhe pret raportime për zgjidhje të problemeve;
- Përgatit materiale raportuese, analiza etj, mbi bazën e materialeve të drejtorive dhe ja dorëzon kryetarit;
- Përfaqson Kryetarin në mbledhje, aktivitete, seminare etj., kur kjo detyrë i ngarkohet nga Kryetari;
- Bashkëpunon me të gjithë drejtuesit e Drejtorive dhe Sektorëve që i ngarkon Kryetari, duke i kërkuar dhe i dhënë ndihmën e nevojshme për realizimin e detyrave të ngarkuara;

Rregullorja e funksionimit të Bashkisë Divjake

- Harton programe dhe politika zhvillimi, të cilat i paqaraqet para Kryetarit të Bashkisë për miratim;
- Ndjek hartimin e Projekt/Buxhetit të vitit dhe asiston drejtoritë përkatëse, deri në miratimin e tij për në Këshillin Bashkiak;
- Ndjek me përgjegjësi Buxhetin dhe i raporton herë pas here Kryetarit të Bashkisë, duke i propozuar për të marrë masa konkrete për përmisimin e gjendjes financiare të Bashkisë;

NENI 31

Sekretarja e Kryetarit

Detyrat e Sekretares se Kryetarit të Bashkisë jane :

- Sistemon e rregjistron të gjitha materialet që qarkullojnë në zyrën e Kryetarit të Bashkisë.
- Evidenton dhe organizon realizimin e axhendës së përditshme të Kryetarit.
- Organizon e siguron rregullsinë e hyrjes së të gjitha materialeve informative për Kryetarin.
- Siguron transmetimin korrektë të porosive që jep Kryetari brenda aparatit të Bashkisë apo në marrëdhënie jashtë tij.
- Nëpërmjet Sektorit të Protokoll – Arkivës pret dhe nis gjithë korrespondencën personale të Kryetarit.

NENI 32

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Emërohet dhe shkarkohet nga këshilli bashkiak , në bazë të propozimit të kryetarit

të këshillit , me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të këshillit .Shkarkimi i sekretarit mund të propozohet edhe nga 1/3 e anëtarëve të këshillit .Kompetencat e sekretarit të këshillit janë :

- Mban dokumentat zyrtare të këshillit ;
- Ndjek punën për përgatitjen e materialeve të mbledhjeve , sipas rendit të ditës ;
- Njofton për zhvillimin e mbledhjeve të këshillit
- Shpall dhe publikon njoftimet e aktet e nxjerra nga këshilli bashkiak ;
- Përgatit seancat e këshillimit me bashkësinë ;
- Mbikëqyr respektimin e rregullores së funksionimit të këshillit .

NENI 33

Zyra e Auditit të Brendshëm

Auditimi i brendshëm është një veprimtari e pavarur, që jep siguri objektive dhe këshilla për drejtimin, i projektuar për të shtuar vlerën dhe për të përmisuar veprimet e administrates se Bashkisë . Ai e ndihmon Bashkinë për të arritur objektivat e veta , me anën e një mënyre të disiplinuar dhe sistematike për të vlerësuar e për të përmisuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut , proceset e kontrollit dhe të qeverisjes së administratës publike . Në këtë funksion përfshihen :

- Hartimi i metodave apo udhëzimeve për fusha të vecanta të auditimit të brendshëm, në zbatim të manualit të auditimit apo akteve të tjera të Ministrisë ë Financave , dhe dërgimi i tyre në Njësinë e Harmonizimit për auditimin e brendshëm.
- Hartimi i planeve vjetore dhe strategjike për veprimtarinë e auditimit të

brëndshëm .

- Kryerja e angazhimeve të auditimit të brëndshëm , sipas udhëzimeve dhe metodave të miratuara nga njësia e harmonizimit për auditimin e brëndshëm , për të vlerësuar nëse sistemet e menaxhimit financiar dhe të kontrollit , si dhe performanca e njësisë së audituar janë transparente dhe në përputhje me normat e ligjshmërisë, të rregullueshmërisë, efektivitetit dhe eficensës .
- Ndjekja dhe raportimi periodikisht për gjetjet , përfundimet dhe rekomandimet , që rezultojnë nga veprimtaritë e tyre audituese, si dhe dhënia e informacionit për njësinë e harmonizimit për auditimin e brëndshëm , për rekomandimet e pazbatuara nga drejtuesit e subjektit të audituar e për pasojat e moszbatimit të tyre
- Përgatitja e raporteve vjetore ose periodike, të cilat i dërgohen njësisë së harmonizimit për auditimin e brëndshëm dhe përmbajnë të dhëna për :
 - angazhimet dhe objektin e auditimit , të kryer gjatë periudhës së raportuar , kohëzgjatjen e cdo auditimi , dhe nëse ka pasur shmangie nga plani , arsyet dhe argumentet përkatëse
 - përfundimet për funksionimin e sistemeve të kontrollit brënda njësisë publike së bashku me rekomandimet për përmisim
 - veprimet e ndërmarra nga menaxhimi për zbatimin e rekomandimeve , si dhe cdo rekomandim të pazbatuar
- Raportimi pas këshillimit me strukturën përkatëse juridike, te drejtuesi i subjektit të audituar , dhe i njësisë së inspektimit , kur zbulon parregullsi apo veprime që përbëjnë vepër penale .
- Auditimi i brëndshëm mbështetet në disa parime si : zbatimi i parimit të ligjshmërisë , zbatimi i parimit të pavarësisë , zbatimi i parimit të paanësisë ,

zbatimi i parimit të fshehtësisë .

- T'i japë Kryetarit të Bashkisë siguri objektive në aspektin e përdorimit dhe menaxhimit ligjor të vlerave monetare dhe materiale nga drejtuesit, punonjësit e administratës së bashkisë, ndërmarrjet dhe institucionet vartëse;
- Të kontrollojë përdorimin e buxhetit, zbatimin e normave ligjore, bazës materiale, ruajtjen e pasurisë publike në administrim të bashkisë dhe të kryejë aktivitet këshillimor, për të mundësuar përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit;
- Auditimi i Brendshëm asiston të gjitha nivelet e menaxhimit në kryerjen efektive të përgjegjësisë të tyre me anë të kontroleve, analizave të pavarura, vlerësimeve, këshillimeve dhe rekomandimeve, lidhur me aktivitetet e ekzaminuara, dokumentet, llogaritë, korrespondencën, asetet fizike dhe të dhëna të tjera të veprimtarisë së bashkisë dhe institucioneve vartëse që çmohen si të nevojshme për kryerjen e procesit të auditimit, të parashikuara në programin vjetor të kontrollit miratuar nga Kryetari i Bashkisë;
- Auditimi i Brendshëm nuk mund të jetë subjekt i ndonjë kufizimi brenda bashkisë apo institucioneve vartëse, por ka akses në çdo periudhë të vitit;
- Funksioni i Auditit të Brendshëm ka karakter konstruktive dhe zhvillohet në frymën e bashkëpunimit me njësitë që auditohen, me synimin e gjetjes së rrugëve të përmirësimit në përmbushjen e objektivave të administratës së bashkisë dhe institucioneve vartëse.

NENI 34

Përgjegjësi Zyrës së Auditit të Brëndshëm

Rregullorja e funksionimit të Bashkisë Divjake

Ka varësi direkt nga Kryetari i Bashkisë dhe ka për detyrë:

- Hartimi i planeve vjetore dhe strategjike për veprimtarinë e auditimit të brëndshëm.
- Hartimi i metodave, udhëzimeve në fusha të veçanta të auditit të brëndshëm, përgatitja e planeve vjetore dhe strategjike, përgatitja e raporteve vjetore si dhe kryerja e angazhimeve të auditit të brëndshëm sipas sipas udhëzimeve dhe metodave të miratuara nga Njësia e Harmonizimit për Auditin e Brëndshëm.
- Siguron një sistem kontrolli brënda njësisë publike, së bashku me rekomandimet për përmisimin e veprimtarisë;
- Përgjigjet për organizimin dhe drejtimin e punës në sektorin përkatës;
- Përgjigjet për përgatitjen e parashikimit të planeve strategjike dhe vjetore për auditimin e brëndshëm;
- Identifikimin dhe menaxhimin e riskut si dhe masat në rast të konstatimit për zhdëmtim dhe uljen e riskut;
- Të ushtrojë në mënyre të pavarur dhe në interes publik funksionin e auditimit;
- Raporton në fund tek titullari në formë të shkruar në rastet kur zbulon parregullsi që në vlersimin e audituesve të brëndshëm përbëjnë vepër penale;
- Shpërndan punën mes vartësve me qëllim që të sigurohet realizimi dhe rezultatet në kohë lidhur me objektivat;
- Menaxhon vartësit duke siguruar drejtimin e tyre dhe monitorimin e performancës.
- Vleron aftësitë dhe performancën e vartësve duke përgatitur vlersimet individuale me shkrim të rezultateve në punë, duke diskutuar ecurinë dhe theksuar fushat në të cilat duhet të bëhen përmisime;
- Harton dhe zbaton plane specifike për fusha të veçanta të auditimit të brëndshëm;
- Përgatitjen e raportit vjetor dhe dërgimi i tij në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brëndshëm;
- Diskuton rezultatet e punës me eprorin dhe i referon atij rastet e problematikave;
- Jep rekomandime për përmisimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brëndshëm të njësisë publike;
- Të sigurojë dhe të kërkojë të dhëna me karakter teknik, ekonomik e financiar dhe menaxherial të njësisë që auditohet;

- Bashkëpunon me kolegët e njësisë organizative përkatëse duke dhënë këshilla dhe opinione me qëllim përmisimin e qeverisjes në njësinë përkatëse, përmisimin e proceseve të kontrollit dhe menxhimin e riskut;
- Mban kontakte me sektorët e tjerë brenda institucionit me qëllim identifikimin dhe menaxhimin e riskut;

NENI 35

Specialisti i Auditit

Është nëpunësi i cili ka varësi direkte nga Përgjegjësi Auditit të Brëndshëm dhe ka për detyrë:

- Siguron një sistem kontrolli brënda njësisë publike, së bashku me rekomandimet për përmisimin e veprimtaris.
- Përgatit parashikimin e planeve strategjike dhe vjetore për auditimin e brëndshëm.
- Identifikimin dhe menaxhimin e riskut si dhe masat në rast të konstatimit për zhdëmtim dhe uljen e riskut.
- Të ushtrojë në mënyre të pavarur dhe në interes publik funksionin e auditimit
- Raporton në fund tek eprori në formë të shkruar në rastet kur zbulon parregullsi që në vlersimin e audituesve të brëndshëm përbëjnë vepër penale.
- Mbi bazën e planifikimit të vitit të kaluar, kryehet planifikimi;
- Te sigurojë vazhdimësinë e punës për realizimin e detyrave dhe objektivave për përmisimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brëndshëm në njësinë përkatëse;
- Sigurohet që puna të kryhet brënda udhëzimeve të përgjithshme dhe afatet e përfundimit të detyrave të realizohen në kohë, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Kryerja e detyrave dhe kërkesave të caktuara që i adresohen të realizohen brënda afatit të caktuar;
- Harton dhe zbaton planin strategjik e vjetor së bashku me eprorin, Kartës së Auditit si dhe akteve të tjera specifike për fusha të veçanta të auditimit të brëndshëm sipas udhëzimeve të dhëna;
- Diskuton rezultatet e punës me eprorin dhe i referon atij rastet e problematikave;

- Jep rekomandime për përmisimin e veprimtarië dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brëndshëm të njësisë publike;

NENI 36

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Sekretari i përgjithshëm është nëpunësi më i lartë civil në institucion.

- Përvec detyrave të vecanta , të ngarkuara nga legjislacioni ne fuqi (Kushtetuta, Rregullore e Kuvendit , ligje etj) ka rolin kryesor ne formulimin e politikave ,
- koordinon dhe garanton përfshirjen e kontributeve të dhëna nga njësitë administrative dhe nga institucionet e tjera gjatë procesit të formulimit të politikave , sipas fushës së përgjegjësisë që mbulon institucioni ,
- siguron zbatimin e vendimeve lidhur me politikat duke ndjekur rregullisht procesin dhe duke marrë masa për zgjidhjen e problemeve ,
- është përgjegjës për përgatitjen , zbatimin, kontrollin e brëndshëm financiar , monitorimin,raportimin ,kontabilitetin,dhe auditimin e brëndshëm të buxhetit të institucionit dhe përgjigjet përpara nëpunësit të parë autorizues në përputhje me legjislacionin për menaxhimin e sistemit buxhetit ne Republikën e Shqipërisë,
- analizon raporte, menaxhon nëpunësit civilë dhe punonjësit e tjerë të institucionit ,
- organizon punën dhe përcakton detyrat sipas njësive kryesore administrative, identifikon mundësitë për reduktim administrativë,

identifikon mundësitë për reduktim të shpenzimeve , për përmisim të politikave , programeve dhe performancës institucionale ,

- garanton respektimin e afateve në nxjerrjen e akteve administrative dhe ruajtjen e sekretit shtetëror, përfaqëson institucionin , me autorizim të titullarit , brënda dhe jashtë vëndit ,
 - kryen detyra të tjera të ngarkuara nga titullari i institucionit .
- Zgjidhja e problemeve. Zgjidh probleme të ndryshme dhe komplekse , që ndikojnë në realizimin e objektivave institucionale .
- Vendimmarrja . Vendimmarrje strategjike , konstante , komplekse, në përputhje me kuadrin ligjor .
- Mjedisi menaxherial . Raporton dhe përgjigjet direkt përpara titullarit të institucionit të pavarur , dhe puna e tij ka ndikim në të gjithë veprimtarinë e institucionit .

Drejtorët japin llogari drejtëpërdrejtë te sekretari i përgjithshëm .

- Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përcaktimin e objektivave dhe detyrave të vecanta të stafit , mbikëqyr veprimtarinë e tyre dhe garanton koordinimin dhe bashkëpunim me njësitë e tjera organizative ,
- siguron zbatimin e vendimeve lidhur me politikën duke ndjekur rregullisht procesin dhe duke marrë masa për zgjidhjen e problemeve ,
- siguron përdorimin eficient të burimeve materiale, njerëzore dhe financiare të nevojshme për realizimin dhe arritjen e objektivave .

NENI 37

SEKTORI JURIDIK DHE PROKURIMEVE PUBLIKE

SHEF SEKTORI

Ka për detyrë :

- Përgjigjet për organizimin dhe drejtimin e punës në sektorin përkatës;
- Organizon punën për hartimin e dokumentave të tenderit duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore dhe në rastet e konstatimit të shkeljeve ligjore ka të drejtën e pezullimit të tyre.
- Merr pjesë në zhvillimin e procedurave të prokurimit dhe mban përgjegjësi për përzgjedhjen e tyre, vendosjen e afateve ligjore dhe respektimin e tyre.
- Raporton tek Autoriteti Kontraktor në rastet kur shikon shkelje të procedurave dhe ka të drejtë ti propozojë pezullimin e praktikës së tenderimit deri në përmirsimin e saj;
- Kujdeset dhe verifikon ligjshmërinë e ndjekjes së procedurave të tenderit gjatë zvellimit të tij.
- Të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet proceduriale;
- Të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- Të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- Të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomik, pjesmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- Drejton dhe organizon punën në sektorin përkatës;
- Organizon punën për hartimin e dokumentave të tenderit;
- Zhvillon procedurat brënda afateve ligjore dhe sipas legjislacionin në fuqi;
- Shpërndan punën mes vartësve me qëllim që të sigurohet realizimi dhe rezultatet në kohë lidhur me objektivat e planifikuara.

Rregullorja e funksionimit të Bashkisë Divjake

- Menaxhon vartësit duke siguruar drejtimin e tyre dhe monitorimin e performancës.
- Bënë verifikimin e dokumentacionit tekniko – ligjor së bashku me Komisionin e Vlersimit të Ofertave në rastet e hapjes së ofertave të një procedure prokurimi, për të kontrolluar shkallën e përgatitjes së kandidatëve në bazë të kërkesave të vendosura nga Enti Prokurues;
- Verifikon ligjshmërinë e ndjekjes së procedurave të tenderit gjatë zhvillimit të tij.
- Harton kontrata sipas klasifikimit të tyre në bazë të procedurës ligjore duke mbrojtur interesat e Institucionit;
- Përgatit korrespondencën për drejtori të tjera pranë Bashkisë ose institucione të tjera sipas rastit;
- Përgatitë materiale për Këshillin Bashkiak brënda afateve kohore të përcaktuara ligjore .

NENI 38

Juristi

- Është nëpunës ne varësi direkte nga Përgjegjësi i sektorit Juridik dhe prokurimeve publike dhe ka këto detyra :
- Siguron një sistem kontrolli brënda njësisë publike, së bashku me rekomandimet për përmisimin e veprimtaris.
- Përgjigjet për organizimin e punës, për trajtimin e ankesave dhe kërkesave të qytetarëve duke respektuar afatet ligjore dhe zgjidhjet juridike të tyre.
- Të hartojë propozime për projektligjet e projektaktet si dhe harmonizimin e akteve nënligjore që lidhen me punën e strukturave të Bashkisë Divjake.
- Përgatit relacione dhe materiale informuese për problemet e ngarkuara nga Kryetari i Bashkisë, N/Kryetari dhe Sekretari i Pergjithshem.
- Të evidentojë në regjistrin e çështjeve gjyqësore të gjitha fletthirrjet e reja dhe të caktojë pjesmarrje në çështje.
- Të parandalojë dhe veprojë menjëherë ndaj kundravajtjeve administrative tek drejtuesit e automjeteve, të cilët zënë hapësirat publike (rrugë, trotuare etj) nga parkimi i automjeteve jashtë vendeve të miratuara nga bashkisë. Në këto raste të bëjë bllokimin e automjetit dhe të vendosë gjobën konform ligjit për mbrojtjen civile ;
- Të marrë masa për ruajtjen e rendit kur ka grumbullime njerëzish, si në tregje, panairë, ceremoni publike, artistike, fetare e sportive, në salla e fusha sportive, objekte të kultit dhe në mjedisë të tjera publike;
- Të kujdeset për respektimin e orarit të shërbimit të njësive tregtare, bufeve, restoranteve, bilardove, lojërave të fatit e objekteve të tjera me veprimtari publike, si dhe për zbatimin nga ana e tyre të urdhëresave apo urdhrave të nxjerra nga kryetari i bashkisë;
- Të ketë nën kontroll territorin e bashkisë dhe të ndërhyjë menjëherë, për të ndaluar e shmangur ndërtimet e paligjshme; të ndalojë zënien e hapësirave publike, si: rrugë, trotuare, troje, ndërtesa e objekte publike të bashkisë, si dhe të marrë pjesë aktive për lirimin e tyre;
- Të kontrollojë marrjen e masave të sigurisë që parandalojnë fatkeqësitë e ndryshme natyrore dhe të ndihmojë në kapërcimin e tyre, duke iu dhënë gjithashtu ndihmë të dëmtuarve në raste urgjence;
- Të marrë masa të përkohshme ndaj të sëmurëve psikikë në gjendje të rëndë (shmangie nga turma) që krijojnë shqetësime për rendin publik;

- Të kujdeset për ruajtjen e afisheve, njoftimeve e shpalljeve publike, si dhe heqjen e atyre të paligjshme ose të paautorizuara;
- Kur konstatohen elemente të veprave penale gjatë kryerjes së shërbimit, punonjësi i policisë bashkiake, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, të marrë masa për shoqërimin e autorëve në komisariatit e policisë; të ruajë vendin e ngjarjes, fiksojë dëshmitarët dhe të ruajë provat deri në ardhjen e policisë gjyqësore;
- Për shkeljet e vërejtura punonjësit e mbrojtjes civile kanë të drejtë të gjobitin në vend personat përgjegjës në masën që parashikohet në ligj;
- Kryen edhe detyra të tjera që i ngarkohen nga eprori më i afërt ose Kryetari i Bashkisë.

NENI 76

DREJTORIA KULTURËS, SPORTIT DHE ARSIMIT

Kjo Drejtori ka si mision :

- Hartimin e politikave dhe strategjive për zhvillimin e , kulturës, Rinisë, dhe Sporteve në qytetin e Divjakës;
- Të sigurojë raporte partneriteti dhe marrëdhënie efektive me gjithë faktorët bashkëpunues në shërbim të ngritjes së cilësisë në sektorin e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve ;
- Të koordinojë punën me grupet e interesit, për zbatimin e projekteve të zhvillimit në funksion të përmirësimit, masivizimit dhe rritjes cilësore të këtyre sektorëve.

Drejtori i Drejtorisë së Kulturës Sportit dhe Arsimit

Ka për detyrë:

- Të hartojë si drejtori ose në bashkëpunim me partnerë të tjerë projekte për zhvillimin e Drejtorisë së Kulturës, Sportit dhe Arsimit në Territorin e Bashkisë Divjakë;
- Përgatit planin mujor të punës me parametra të matshëm dhe sigurohet që personat e janë përgjegjës për të ta realizojnë në kohë dhe në përputhje me ligjin;
- Të koordinojë punën e sektorëve të drejtorisë, komunitetit të biznesit, stafet e kulturës dhe sporteve me fondacione dhe OJF, për të rritur shkallën e bashkëpunimit me interesa reciproke në funksion të projekteve të zhvillimit;
- Zbaton politikat shtetërore në fushën e artit dhe të kulturës;
- Administron dhe planifikon fondin publik të artit;
- Të mbaj lidhje me organizatat lokale dhe kombëtare që trajtojnë prolemet e të rinjve për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta sportive dhe kulturore;
- Organizon projekte muzikore sipas një programi vjetor, projekte teatrore, të arteve dhe projekte filmike;
- Harton udhëzues për mbirëmbajtjen e trashëgimisë kulturore.
- Inkurajon bashkëpunimin dhe koordinimin mes të gjitha agjensive të trashëgimisë, etniteteve dhe individëve të interesuar në bashki.
- Evidentimin në terren të potencialeve kulturore (materiale dhe shpirtërore).
- Organizon aktivitete të ndryshme ku do të theksohen traditat, zakonet , dhe produktet kulturore.
- Përpilon regjistrin e elementëve të trashëgimisë kulturore material dhe

shpirtërore në bashkëpunim me institucionet shkencore dhe me ekspertë në Bashkinë Divjakë.

- Organizon forume të rregullta të trashëgimisë kulturore me qëllim informim e vazhdueshëm të palëve të interesuara;

NENI 77

Përgjegjësi i Kulturës dhe i Sportit

Ka për detyrë:

- Të hartojë si sektorë ose në bashkëpunim me partnerë të tjerë projekte për zhvillimin e sektorit të , kulturës Rinisë, Sporteve në territorin e Bashkisë Divjakë;
- Të monitorojë zbatimin e projekteve dhe të përgatisë raporte vlerësuese mbi realizimin e tyre;
- T’iu sigurojë asistencën e nevojshme grupeve të interesit, për përgatitjen e projekteve dhe paraqitjen e tyre tek donatorë të ndryshëm, për miratim e financim;
- Të koordinojë punën e sektorëve të drejtorisë, komunitetit të biznesit, stafet e kulturës dhe sporteve me fondacione dhe OJF, për të rritur shkallën e bashkëpunimit me interesa reciproke, në funksion të implementimit të projekteve të zhvillimit;
- Të kryejë studime për gjendjen dhe shtrirjen e rrjetit të shkollave, të

kopshteve e qendrave të fëmijëve;

- Të organizojë kontrole të vazhdueshme për gjendjen e ambienteve të brendshme të institucioneve të kulturës, duke parashikuar masa për mirëmbajtjen, riparimin dhe kompletimin me bazën e nevojshme materiale

NENI 78

Punonjës për aktivitetet kulturore

Është nëpunës me varësi direkte nga përgjegjësi i kulturës dhe i sportit dhe ka si detyrë :

- Të punojë për administrimin dhe gjallërimin e jetës kulturore dhe artistike të qytetit të Divjakes , në përputhje me politikat e bashkisë, me fokus të veçantë zhvillimin e aktiviteteve rinore;
- Koordinon punën midis institucioneve vartëse (Qendrën Kulturore dhe Klub Sportin dhe Qendrën Kulturore të Fëmijëve etj);
- Përgatit materialin e duhur për një projekt kulturor.
- Mbikqyr organizimin dhe realizimin kulturor të gjithë ceremonialeve zyrtare;
- Koordinon punën me sektorë të tjerë, për realizimin e projekteve të përbashkëta të fushës kulturore dhe artistike;
- Mban lidhje me organizatat rinore (parlamentin rinor dhe qeveritë e shkollave) lokale dhe kombëtare, të cilat trajtojnë problemet e të rinjve për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta, kulturore dhe artistike;
- Ndjek organizimin e veprimtarive kulturore sipas kalendarit të programuar për vitin;

- Evidenton pasuritë kulturore të qytetit, si ato arkeologjike, etnografike, figurat historike të qytetit etj., dhe organizon veprimtari për promovim vlerash;
- Mban lidhje me krijues të fushave të ndryshme, si të arteve figurative, krijimtarisë poetike, të trashëgimisë kulturore të qytetit, të instrumentistëve etj., dhe organizon hërë pas hërë takime promovuese me ta;
- Kryen edhe detyra të tjera që i ngarkohen nga eprorët e tij.

NENI 79

Punonjës për aktivitetet e rinisë

Është nëpunësit civil, ne varësi nga sektori i kulturës dhe i sportit dhe ka për detyrë :

- Të drejtojë hartimin e politikave dhe strategjive për zhvillimin e turizmit & sportit në qytet, në përputhje me strategjinë e përgjithshme të zhvillimit të qytetit;
- Të identifikojë dhe sigurojë kontakte të vazhdueshme me të gjitha agjencitë turistike që kanë aktivitet në qytetin e Divjakës , për të mundësuar donacione në shërbim të turizmit kulturor, arkeologjik dhe etnografik;
- Të sigurojë marrëdhënie partneriteti me sektorët turistikë, Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë dhe partnerë të tjerë, në funksion të implementimit të projekteve në fushën e turizmit;
- Të koordinojë punën për zbatimin e projekteve të përbashkëta të Bashkisë me fondacione, OJF dhe grupe të tjera të interesit, kur ata janë pjesë e

donacioneve në këto projekte;

- Të mundësojë përfshirjen e të rinjve të qytetit në projekte sensibilizimi për propagandimin e nismave me interesa lokale, në funksion të zhvillimit të turizmit kulturor;
- Bashkëpunon me agjenci të ndryshme turistike, për ta përfshirë Divjakën në guidat turistike në shkallë vendi;
- Punon për hartimin e guidës turistike të qytetit, si dhe të një DVD-je me pamje nga pikat historike e turistike të Divjakës ;
- Organizon, ndjek dhe nxitë masivizimin dhe rritjen e cilesisë sportive në qytetin e Divjakës në përputhje me kushtet dhe prioritetet e bashkisë, me sens të veçantë nxitjen dhe aktivizimin e moshave të reja;
- Merr masa për mbështetjen e nxitjen e talenteve të reja për sportet;
- Organizon studime të ndryshme për zhvillimin perspektiv të sportit;
- Përgatit materiale dhe informacione që kanë të bëjnë me sektorin që mbulon dhe informon Drejtorin direkt;
- Në bashkëpunim me Klubin Shumësporte harton programin e aktiviteteve sportive për vitin në vijim;
- Ndjek kalendarin e aktiviteteve të klubitshumësportësh “Divjaka “;
- Kërkon tek drejtuesit e sektorit të sportit mirëmbajtjen e vazhdueshme të ambienteve sportive;
- Kryen edhe detyra të tjera që i ngarkohen nga eprori direkt ose titullari i bashkisë.

NENI 80

Punonjës për aktivitetet sportive

- Qëllimi i këtij punonjësi është të nxisë , organizojë punën mbi baza ligjore dhe profesionale , duke bashkëpunuar me institucione dhe hallka të ndryshme sportive e rinore , për të zhvilluar kulturën sportive në komunitet .
- Harton projekte për ndërtimin e terreneve , ambienteve sportive në favor të zhvillimit të aktivitetit lëvizor , ripërtëritjen dhe argëtimin e masave të gjera meshkuj dhe femra .
- Ndërhyn për disiplinimin e zhvillimit stërvitor nga instruktorë dhe trajner të cilët janë të pajisur me certifikata , që garantojnë nivelin e cilësisë së tyre profesionale .
- Propogandon sportin olimpik që ka rregulla të precizuara, të qarta dhe të pastra
- Harton plane javore , mujore , vjetore dhe ia paraqet për miratim eprorit direkt
- Organizon projekte sportive dhe seminare për zhvillimin e kulturës sportive në kopshte, shkolla, dhe për publikun e gjerë .

NENI 81

Trajner për lojrat me dorë

Ka si mision :

- Të organizojë,të ndjekë, nxisë masivizimin dhe rritjen e cilësisë së lojërave me dorë si volejboli, basketbolli, tenisi etj në përputhje me kushtet dhe

prioritetet e Bashkisë , me sens të vecantë nxitjen dhe aktivizimin e moshave të reja

- Merr masa për mbështetjen e nxitjen e talenteve të reja për sportet
- Organizon studime të ndryshme për zhvillimin perspektiv të lojërave me dorë
- Përgatit materiale dhe informacione që kanë të bëjnë me sektorin që mbulon dhe informon eprorin direkt
- Ndjek kalendarin e aktiviteteve te ekipit të volejbollit për Divjakën
- Kërkon tek drejtuesit e sektorit të sportit mirëmbajtjen e vazhdueshme të ambienteve sportive
- Organizon dhe merr pjesë në ndeshjet e ekipit të Divjakës me qytetet e tjera si brënda Divjakës ashtu edhe jashtë qytetit të Divjakës
- Depoziton kërkesa pranë Bashkisë për të gjithë bazën materiale vjetore të nevojshme
- Organizon plan pune vjetor, mujor për të gjithë aktivitetin që do të zhvillohet
- Kryen edhe detyra të tjera që i ngarkohen nga eprori direkt ose nga titullari i Bashkisë

NENI 82

Trajner futbollit

Ka si mision :

- Të nxisë aktivizimin e moshave të reja në futboll
- Merr masa për mbështetjen e nxitjen e talenteve të reja për sportet
- Organizon studime të ndryshme për një zhvillim më të mirë të sportit të volejbollit
- Përgatit materiale dhe informacione që kanë të bëjnë me sektorin që mbulon dhe informon eprorin direkt
- Ndjek kalendarin e aktiviteteve të ndeshjeve që zhvillohen
- Kërkon tek drejtuesit e sektorit të sportit mirëmbajtjen e vazhdueshme të ambienteve sportive
- Organizon dhe merr pjesë në ndeshjet e ekipit të futbollit të Divjakës me qytetet e tjera si brenda Divjakës ashtu edhe jashtë qytetit të Divjakës
- Depoziton kërkesa pranë Bashkisë për të gjithë bazën materiale vjetore të nevojshme
- Organizon plan pune vjetor, mujor për të gjithë aktivitetin që do të zhvillohet
- Kryen edhe detyra të tjera që i ngarkohen nga eprori direkt ose nga titullari i Bashkisë

NENI 83

Punonjës biblioteke

Bibloteka e qytetit të Divjakës funksionon në bazë të ligjit nr.9616 datë 27.9.2006 Për librin në Republikën e Shqipërisë , të ligjit nr.8756 datë 3.2.2000 Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar .

Detyrat e këtij punonjësi janë :

- të administrojë bibliotekën e qytetit dhe të mbajë përgjegjësi për cdo humbje, prishje, djegie, apo dëmtime të tjera të bazës materiale

NENI 84

Mirëmbajtës stadiumi

Ka si mision :

- të kujdeset për mirëmbajtjen e godinës së stadiumit
- të depozitojë kërkesa pranë bashkisë sa herë është e domosdoshme për riparimet e stadiumit
- të mbajë rregull gjatë kohës që zhvillohen ndeshje në stadium

NENI 85

SEKTORI I RRUGEVE RURALE DHE ADMINISTRIMIT TE PYJEVE

NENI 86

Shef Sektori

- Pergatit planin vjetor te punes
- Kontrollon mbarevajtjen e punes
- Manaxhon dhe kontrollon punonjesit
- Kontrollon veprat e artit neper rruget rurale
- Kujdeset per pastrimin e rrugeve
- Harton librin e sigurimit teknik

NENI 87

Punonjes Menaxhimit te Punimeve dhe Mjeteve

- Perllogarit sasite e nevojshme te karburantit sipas punimeve qe do te kryhen per te gjithe vitin kalendarik
- Mban dhe harton kartelat per cdo mjet
- Siguron te gjithe dokumentacionin e nevojshem te mjeteve
- Siguron flete udhetimet per cdo mjet

NENI 88

Inxhinier mekanik

Të përgatisë oferta për punime mekanike;

Të planifikoj, organizoj dhe punën e manovratoreve dhe të sigurojë të gjitha punimet të kryera sipas kërkesave;

Siguron asistencë teknike në hulumtimin mbi zhvillimin e makinave dhe instalimeve mekanike;

Përgatit vlersime të detajuara të sasive dhe kostot e materialeve dhe punës;

Analizon defektet në mjetet tërheqëse dhe merr masa për mirëmbajtjen e tyre;

Organizon, harton dhe vërteton nevojën për pjesë rezervë (pjesë, vegla dhe pajisje).

Analizon defektet në mjetet dhe merr masa për mirëmbajtjen e tyre;

Përpilon kërkesat për furnizimin me naftë, vajra dhe materiale të tjera;

Përgatitë raportet ditore, javore e mujore;

NENI 89

Manovrator

Ka si mision :

- operon me mjetet e renda si eskavator , fadrome me goma
- ben ngarkime , rregullime te terrenit , pastrim kanalesh , zhvendosje mbeturinash, nivelim sipërfaqesor, per territoret e bashkisë.

NENI 90

Shoferi

Është punonjës i administratës, i cili varet ngaPergjegjesi i Burimeve Njerëzore dhe ka për detyrë:

- Të mbajë në gatishmëri teknike dhe të pastër automjetin që drejton dhe të zbatojë me rigorozitet rregullat teknike në punë, si dhe rregullat e qarkullimit rrugor;
- Në çdo rast lëviz me urdhër të Kryetarit të Bashkisë ose të Pergjegjesit të Burimeve Njerëzore;
- Të zbatoje të gjitha rregullat e etikës, në paraqitjen e jashtme, komunikimin me eprorin direkt, me punonjës të tjerë të bashkisë dhe banorë të qytetit, rregulla të cilat janë përfshirë në këtë rregullore;

NENI 91

Mekanik

Ka si mision :

- mirembajtjen teknike te gjitha mjeteve te bashkise
- nderrimin e pjeseve te demtuara me te reja
- kontrollin periodik mbi nivelin e vajrave qe duhet te kene mjetet
- kontrollin mbi gjendjen teknike te tyre
- kontrollon gjëndjen e frenave
- kontrollon gjendjen e gomave
- cmontimin e pjeseve te demtuara dhe zevendesimin e tyre me pjese te reja

NENI 92

Punonjes Mirembajtje

- kujdeset per mirembajtjen e rrugeve rurale
- rregullimin e bankinave anesore te rrugeve rurale
- pastrimin e kanaleve anesore
- pastrimin e veprave te artit
- hapje cakulli ne rruge
- hapje rere bituminoze ne rruge
- prerje e bimeve te ndryshme ne bankinen anesore te rrugeve rurale
- heqje dherash nga rruga

NENI 93

Teknik i Mesem Pyjor

- Ruan pyjet nga prerjet e paligjshme
- Kujdeset per pastrimin e tyre
- Ruan pyjet nga renia e zjarreve
- Ruan pyjet nga nderhyrjet e paligjsheme te komunitetit

NENI 94

Zyra e pritjes dhe Informimit të publikut

- Kjo zyrë ka si mision :
- organizimin e orareve të pritjes me titullarët dhe specialistët sipas fushave

- pritja dokumentimi dhe organizimi i procedurave për trajtimin e shkresave hyrëse
- shërbimi i informimit paraprak të klientëve lidhur me aplikimet për shërbimet
- përpunimi i formularëve të për ankesat dhe kërkesat
- ndihma për qytetarët në përpilimin e aplikimeve sipas kërkesave të kuadrit ligjor
- publikimi i të dhënave të detyrueshme bazuar në të drejtën e informimit
- plotësimi i kërkesave të qytetarëve për informim për dokumentat zyrtare
- krijon kushte për realizimin e shërbimeve
- organizon shërbimin e këshillimit juridik e teknik nëpërmjet sporteleev
- realizon komunikimin me agjencitë jashtë institucionit
- komunikon me titullarin dhe drejtuesit e tjerë të administratës
- ndjekja e detyrave të lëna nga titullari
- koordinimi i veprimeve të strukturave të brëndëshme të administratës
- publikimi i informacioneve që i shërbejnë maksimizimit të transparencës
- ndjekja e zbatimit të afateve ligjore për kthimin e përgjigjeve ndaj aplikimeve
- evidentimi dhe përpunimi i ankesave e propozimeve të mbërritura
- përgatitjen e raporteve periodike sipas formateve standarte të miratuara paraprakisht .

NENI 95

Nëpunës të Gjëndjes Civile

- Në fillim të cdo viti vërteton modelin e regjistrave që do të përdoren për regjistrimin e akteve të gjëndjes civile
- Administrojnë arkivin e gjëndjes civile në Bashkinë Divjakë
- Ruan dokumentet bazë të qytetarëve si : akti i lindjes , akti i martesës , akti i vdekjes, regjistrat themeltarë, procesverbali për ndryshim emri , mbiemri , kërkesat për shkëputje apo bashkim familjar
- Lëshon në shërbim të qytetarëve dhe me kërkesë të tyre certifikatë lindje , certifikatë martesore , certifikatë familjare dhe certifikatë vdekje .
- Nënshkruan cdo dokument që lëshon ku në cdo rast nënshkrimi shoqërohet me vulën e zyrës së gjëndjes civile, në të kundërt veprimi është i pavlefshëm
- Mbyll aktet më 31 dhjetor të cdo viti pas rishikimit të saktësisë së veprimeve të kryera dhe i dorëzon ato jo më vonë se data 20 janar e vitit pasardhës , në arkivin e degës së gjëndjes civile të qytetit të Divjakës .

NENI 96

NJESITË ADMINISTRATIVE

Në njësitë administrative funksionon administrata që drejtohet nga administratori .

- Administratori emërohet dhe shkarkohet nga kryetari i bashkisë dhe është përgjegjës para tij për funksionimin dhe veprimtarinë e administratës .
- Administratori duhet të ketë vendbanimin në njësinë administrative përkatëse .

- Struktura dhe organika e administratës së njësive administrative janë pjesë të strukturës dhe organikës së administratës së bashkisë .
- Misioni i Njesive Administrative ;
- Jane struktura te Bashkise Divjakë te cilat ushtrojne veprimtarine e tyre sipas shtrirjes gjeografike mbi komunitetin qytetar ne perputhje me aktet ligjore e nenligjore ne fuqi.
- Pergjigjen per sigurimin e veprimtarise jetesore ne teritorin nen juridiksionin e tyre.

NENI 97

Detyrat e Administratës së Njesive Administrative

Administrata e njësive administrative kryen këto detyra :

- 1.është zyrë e shërbimit për të gjitha procedurat administrative në kompetencën e bashkisë
- 2.mbikqyr territorin për zbatimin e ligjit në të gjithë fushat në kompetencë të bashkisë në rast konstatimi të veprimeve në kundërshtim me ligjin
- 3.mbështet punën e strukturave kompetente të bashkisë
- 4.bazuar në vendimmarrjen e kryetarit të bashkisë mund të administrojë parqet , lulishtet dhe zonat e gjelbëruara
- 5.bazuar në vendimmarrjen e kryetarit të bashkisë mund të administrojë tregjet publike

- 6.bazuar në vendimmarrjen e kryetarit të bashkisë mund të administrojë terrenet sportive, bibliotekat , shtëpitë dhe klubet e rinisë ,
- përgatit dhe i propozon kryetarit të bashkisë planin për investimet nën juridiksionin e saj territorial , si dhe mbikqyr pas miratimit zbatimin e tyre sipas ligjit
- propozon sipas ligjit emërtimin e rrugëve , shesheve , institucioneve dhe objekteve që janë nën juridiksionin e saj territorial
- mbështet koordinon dhe mbikqyr veprimtarinë e kryetarëve të kryesisë së fshatrave
- i propozon kryetarit të bashkisë dhënien e titujve të nderit dhe stimujve për personat nën juridiksionin e saj territorial
- propozon marrjen e nismave në dobi të komunitetit me mundësi të barabarta dhe përfitime nga të gjithë brënda juridiksionit të saj territorial
- kryen çdo funksion tjetër të deleguar nga kryetari i bashkisë .

NENI 98

ADMINISTRATORI

- Administratorët e Njësive Administrative në përbërje të Bashkisë të pajisen me vulën e Njesisë Administrative.
- Administratorët e njësive Administrative kanë kompetencë të plotë në ofrimin e shërbimeve të parashikuara nga ligji nr.139/2015 datë 17.12.2015 “ *Për vetëqeverisjen Vendore* “ .
- Administrata e Njesisë Administrative është e detyruar të pranojë çdo kërkesë të banorëve të Njesisë Administrative, t’ a përcjellë atë në sektorin

përkatës të administratës së Bashkisë dhe të ndjekë procesin e marrjes së përgjigjes dhe dorëzimit të saj tek aplikuesi.

- Administratorët e Njësive Administrative kanë të drejtë të ofrojnë shërbimet e mëposhtme :
 - Shërbimi i gjendjes civile nëpërmjet zyrës së gjendjes civile pranë Njesisë.
 - Pranimi dhe verifikimi i dokumentacionit për kërkesat për ndihmë ekonomike. Më tej dokumentacioni i përcillet për miratim strukturës përkatëse të Bashkisë dhe Këshillit të Bashkisë.
 - Dhënia e vërtetimeve për çështje që lidhen me dokumentacionin që ndodhet në arkivën e Njesisë Administrative, gjithmonë duke u bazuar dhe me referencë në të dhënat e dokumentacionit që ndodhet në arkivën e Njesisë Administrative.
 - Dhënia e kopjes së dokumentacionit që ndodhet në arkivën e Njesisë Administrative dhe nënshkrimin për njësimin e saj me origjinalin.
 - Dhënia e vërtetimeve për çështjet që kanë të bëjnë me dokumentacion që ndodhet në arkivën e Bashkisë, vetëm pas verifikimit të dokumentacionit përkatës (duke komunikuar me punonjësin e arkivës së Bashkisë) dhe vetëm me referencë në të dhënat e dokumentit përkatës.
- Administratorët e Njësive Administrative kanë të drejtë të nënshkruajnë dhe vulosin për legalizimin e dokumentave që prodhon sistemi dixhital i Bashkisë (për ato fusha të veprimtarisë ku ekziston një sistem i tillë).
- Administratorët e Njësive Administrative kanë të drejtën e kontrollit të territorit, të mbajtjes së procesverbaleve përkatëse për kundravajtjet

administrative të konstatuara dhe më pas janë të detyruar të njoftojnë strukturën përkatëse të Bashkisë për të vazhduar procedimin e mëtejshëm.

- Funksione të tjera që i delegohen nëpërmjet urdhërave të nxjerra nga kryetari i Bashkisë në përputhje me ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “ *Për vetëqeverisjen Vendore* “ .

NENI 99

Administratori shoqëror

- Të identifikojë familjet në nevojë për ndihmë ekonomike si dhe të verifikojë gjëndjen social – ekonomike të tyre;
- Grumbullon informacione dhe harton statistika mbi nevojat që ka sektori për shtimin e financimit në varësi të gjëndjes ekonomike dhe numrit të familjarëve që janë ose duhen shtuar në skemën e ndihmës ekonomike;
- Llogarit me përgjegjësi dhe mbi bazë kriteresh ligjore masën e përfitimit të ndihmës ekonomike;
- Mbledh dhe verifikon dokumentat e aplikantëve përfitues dhe të aplikantëve të rinjë, përpilon dosjet dhe evidencat përkatëse;
- Përgatit evidencat dhe regjistrat përkatës të përfituesve;
- Ruan, sistemon dhe trajton dosjet e përfitimeve konform me ligjin dhe rregullat e arkivit;
- Sqaron qytetarët për të kuptuar të drejtat dhe obligimet e tyre në fushën e

përkujdesit shoqëror;

- Siguron që personat me aftësi të kufizuar të kenë mundësi të barabarta, mos të ketë diskriminime;
- Përpilon cdo muaj listën e personave që do të trajtohen me ndihmë ekonomike dhe në datën 15 të cdo muaji dërgohet në Bashki për ti kaluar në Këshill Bashkiak.

NENI 100

Specialistë arkivë / protokoli

- Rregjistron korrespondencën zyrtare, shpërndanë dhe përpunon atë.
- Organizon punën për evidentimin, ruajtjen fizike, përpunimin dhe shfrytëzimin e dokumentave në bazë të ligjeve në fuqi.
- Protokollon vendimet dhe urdhërat e Kryetarit të Bashkisë, si dhe praktikën shkresore të Bashkisë Divjake nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë apo persona të tjerë të autorizuar me urdhër të veçantë me shkrim prej tij.
- Punon për gjetjen e shkresave dhe dokumentave që kërkohen nga drejtoritë e Bashkisë.
- Protokollon dokumentat që hyjnë dhe dalin nga Njësia administrative
- Shkresat dhe dokumentat nisen në postë nën interesimin e vetë protokolluesit.
- Kryen indeksimin e shkresave të ardhura
- Përgjigjet për rregullsinë e rregjistrimit të dokumentacionit në librat e protokollit.
- Organizon dhe drejton punën për përpunimin e dokumentave në fund të vitit.

- Bën njehsimin e dokumentave me origjinalin, duke i sigluar ato në çdo faqe.
- Kontrollon cilësinë e përpilimit të dosjeve.
- Ndjek përdorimin korrekt të vulës dhe përgjigjet për sigurimin e saj në bazë të ligjeve.
 - Ndjek arkivimin dhe përpunimin e korrespondencës dhe ruajtjen e fondit arkivor;
 - Organizon punën në sektorin e arkivës për evidentimin, ruajtjen fizike, përpunimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve në bazë të ligjit nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivin” dhe ligjin 8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”;
 - Përpunon dokumentet e regjistruara, duke i sistemuar sipas dosjeve dhe drejtorive përkatëse;
 - Kryen indeksimin e shkresave të ardhura në arkiv dhe kontrollon cilësinë e përpilimit të dosjeve;
 - Punon për gjetjen e shkresave dhe dokumenteve që kërkohen nga drejtoritë e bashkisë;
 - Nxjerr nga arkiva dokumentet e kërkua nga institucionet, qytetarët e sektorët e bashkisë (vetëm me kërkesë zyrtare nga drejtori);
 - Bën njehsimin e dokumenteve të ndodhura në arkiv me origjinalin, duke i sigluar ato në çdo faqe.
 - Merr në dorëzim të gjithë materialin arkivor dhe bën përpunimin e tij sipas kërkesave ligjore;
 - Përpunon dokumentet e vitit të kaluar;
 - Sistemon në arkiv fondin sipas strukturës dhe viteve përkatëse;

- Sistemon dokumentet e tenderit, të cilat dorëzohen në arkiv me përfundimin e praktikave të tyre, duke i marrë me inventar, një për një, me përgjegjësi, të cilat nxirren nga arkivi konform kërkesës së ligjit e rregullores së arkivit;
- Bën përpunimin e dosjeve dhe verifikon dosjet që iu ka mbaruar afati i ruajtjes, të cilat ia paraqet komisionit përkatës për asgjësim;
- Punon për sigurimin e kushteve teknike në arkivin e bashkisë;
- Në bashkëpunim me arkivin e qarkut Fier realizon dorëzimin e dokumenteve sipas afateve dhe kërkesave ligjore;
- Kryen edhe detyra të tjera të ngarkuara nga përgjegjësi direkt.

NENI 101

Specialist i menaxhimit të tokës

Ka si mision :

- Përgjigjet për menaxhimin dhe mbrojtjen e tokës bujqësore, në pronësi shtetërore dhe private si dhe kategorive të resurseve për territorin e Bashkisë Divjakë.
- Të caktojë kufijt e parcelave të tokës sipas kërkesave të paraqitura nga qytëtarët;
- Të mbajë regjistrat themelorë kadastralë të japë të dhëna dhe të kryejë shërbime ndaj të gjithë qytetarëve;
- Përgjigjet për grumbullimin dhe sistemimin e e dokumentacionit të ri kadastral për territorin e Bashkisë Divjakë;

- Merr masa në kohë për ruajtjen fizike dhe pjellorinë e tokës nga ndotja dhe degradimi;
- Të bëjë planifikimin e përdorimit të tokës, ndryshimin ndërmjet zonave kadastrale;
- Raporton tek Kryetari kërkesat e subjekteve të interesuara për ndryshim të kategorive të resurseve të tokës dhe përgatit raportet teknike për këto kërkesa;
- Ndjek zbatimin e procedurave për qiradhënien e tokave bujqësore të pandara brenda territorit të bashkisë, bazuar në dispozitat e legjislacionit në fuqi;
- Bashkëpunon dhe shkëmben të dhëna me seksionin e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në qark;

NENI 102

Nënpunës i gjëndjes civile

- Objekti i punës së Pergjegjesit të Seksionit të Gjëndjes Civile është organizimi i punës për një shërbim sa më të efektshëm dhe korrekt ndaj qytetarëve që kanë nevojë për shërbimet e zyrës së gjëndjes civile. nënpunësi ka si detyrë :
 - të përditësojë Regjistrin Kombëtar të Gjëndjes Civile
 - të mirëmbajë aktet e lindjes, të martesave , dhe të vdekjeve
 - të lëshojnë dokumentin e identitetit, certifikatat e lindjes, ato familjare , të martesës, të vdekjes, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj ,
 - të kryejë veprime të shërbimit të gjëndjes civile, sipas përcaktimeve të bëra

në këët ligj dhe në aktet nënligjore në fuqi ,

- të plotësojnë detyrimet e përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore të institucioneve të tjera shtetërore dhe të subjekteve të interesuara
- të vënë në dijeni këshillin ose kryetarin e bashkisë si edhe degen e gjendjes civile në qark për veprimtaritë e zyrës së gjendjes civile, sipas kërkesës ose periodikisht , në përputhje me udhëzimet përkatëse,
- të plotësojnë të gjitha detyrat në përputhje me legjislacionin në fuqi .

NENI 103

Roje objektsh

- Te jetë nëpunesi i parë që hap godinën e Bashkisë dhe bën një kontroll të përgjithshëm të ambienteve të punës, korridoreve, zyra, holle etj. dhe për cdo parregullësi që vëren njofton Përgjegjesinë e Burimeve Njerëzore.
- Orienton qytetarët për adresat e zyrave apo zyrtarëve që kërkojnë për takim për zgjidhjen e halleve dhe ankesave që kanë, duke organizuar dhe shoqërimin e tyre pranë zyrave dhe zyrtarëve perkates.
- Nuk lejon të futen në ambiente të Bashkisë persona të papërgjegjshëm, që shkelin rregullat, prishin qetësinë e zyrave apo që nuk shënojnë të dhënat e kërkuara në regjistrin përkatës dhe për këtë bashkëpunon me policinë bashkiake.
- Kryen dhe detyra te tjera qe i ngarkohen nga titullari apo shefi i drejtpërdrejtë konform mundësive dhe natyrës së punës së tij.

NENI 104

Sanitarja

Është punonjëse e administratës, dhe ka për detyrë:

- Të pastrojë dhe mirëmbajë nga ana higjienike sipërfaqen e zyrave, koridoreve, shkallëve të godinës që janë në administrim të bashkisë.
- Të pastrohen pluhurat në orenditë e zyrave, si dhe xhamat jo më pak se një herë në javë.
- Të përkujdeset për mirëmbajtjen dhe ujitjen e vazove me lule në ambientet e Bashkisë.
- Të përdorë për pastrimin e Bashkisë larës detergjent.
- Të pastrojë dhe mirëmbajë rrugicat , muketet etj.
- Të mbajë kontakt të rregullt me Pergjegjesine e Burimeve Njerëzore për çdo problem disipline, furnizimi apo kërkesë të çfardoshme

NENI 105

Përgjegjës i shërbimeve publike

Ka për detyrë :

- Të studiojë dhe zbatojë politika, strategji dhe programe zhvillimi në fushën e përmirësimit të shërbimeve publike dhe punëve të tjera në Njesinë administrative perkatese . Gjithashtu, të udhëheqë sektorët përkatës për të hartuar strategjitë dhe perspektivat e zhvillimit në fushën e shërbimeve dhe

infrastrukturës publike;

- Të organizojë punën për hartimin e projektplanit dhe buxhetit të shërbimeve publike për sipërmarrjet private dhe sektorin e shërbimeve që mirëmban infrastrukturën publike në Njesine Administrative ;
- Të ndjekë dhe kontrollojë zbatimin e vendimeve të Këshillit Bashkiak për probleme që kanë lidhje me Njesine Administrative perkatese ;
- Të përgatitë informacione periodike mbi punën e Njesise Administrative ;
- Të mbajë lidhje periodike me ente private ose shtetërore, veprimtaria e të cilëve ka të bëjë direkt ose indirekt me infrastrukturën publike si: Ndermarrjen Ujësjellës-Kanalizimeve, Filiali Elektrik, Telekom etj;
- Të hartojë programe afatshkurter dhe afatmesem për përmirësimin e shërbimeve dhe infrastrukturës publike;
- Të përgatitë informacione periodike dhe t’ia paraqesë ato Kryetarit të Bashkisë, për mbështetje ose analiza, në funksion të përmirësimit të punës në sektorët që mbulon;
- Të vlerësojë punën vjetore të vartësve dhe t’i propozojë Kryetarit të Bashkisë masa për përmirësimin e punës.

NENI 106

Punonjës pastrimi , mirëmbajtje dhe K.U.Z

Kanë si mision :

- pastrimin , rregullimin e njesive administrative
- mbledhjen trajtimin dhe largimin e ujërave të ndotura

- mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut dhe mbrojtjen nga përmbytjet në zonat e banuara
- ndërtimin , rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve të njësisve administrative dhe sinjalizimet rrugore , të trotuareve dhe shesheve publike vendore
- ndricimin e mjediseve publike
- rehabilitimin , mirëmbajtjen e varrezave publike , si edhe garantimin e shërbimit publik të varrimit
- shërbimin e dekorit publik
- parqet lulishtet dhe hapsirat e gjelbërta publike
- mbledhjen , trajtimin, largimin e mbetjeve të ngurta dhe ato shtëpiake në njësitë administrative

SEKTORI I MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMI

Shefi i Sektorit ka për detyrë:

- Të marrë masa për parandalimin dhe ndërhyrjen për shuarjen e zjarreve
- Të organizojë punën për rritjen e gatishmërisë së mjeteve, pajisjeve dhe presonelit për rritjen efikasitetit për ndërhyrjen në kohë për shuarjen e zjarreve
- Zbatimin e ligjshmërisë, zbatimin e masave parandaluese për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi
- Mbajtjen dhe administrimin e dokumentacionit të MZSH – së si dhe përpilimin e statistikave për aktivitetet dhe veprimtarinë e shërbimeve në përputhje me legjislacionin në fuqi
- Drejton dhe përgjigjet për rritjen e aftësive profesionale dhe zhvillon

mësime treguese për dhënien e njohurive të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi

- Kryen herë pas here stërvitje të punonjësve të MZSH – së për të qënë sa të gatshëm dhe të pregatitur në rastet e renies së zjarreve dhe të parandalimit të tyre
- Në raste rënie të zjarreve të bashkëpunoj me Policinë e Shtetit për përcaktimin e shkaqeve që cuan në rënien e zjarrit
- Të bashkëpunoj me strukturat e Policisë së Shtetit, me institucione të tjera të sigurisë publike, me Strukturat e Forcave të Armatosura, Shërbimin e mbrojtjes Civile, shërbimi i organeve mjeksore për shpëtimin e jetës së njërzëve dhe pronës nga zjarri

Inspektor i parandalimit të MZSH

- Marrjen e masave të inspektimit, parandalimit dhe ndërhyrjes për shuarjen e zjarreve
- Kryerjen e inspektimeve të herëpashershme në zonat të cilat janë më problematike dhe më të rrezikuara nga zjarri
- Të marrë masa për parandalimin dhe pakësimin e zjarreve me anë të mjeteve ose pajisjeve për shuarjen e zjarrit gjatë aktivitetit të tyre
- Të inspektoj cdo lloj objekti i cili bënë pjesë brënda juridiksionit të Bashkisë Divjakë dhe të marrë masa sipas legjislacionit në fuqi për të gjitha ato objekte të cilat përbëjnë rrezik për rënien e zjarrit
- Mbajtjen e cdo statistike dhe dokumentacioni per cdo objekt ose zona të rrezikuara nga zjarri
- Të kontrollojë vazhdimisht të gjitha mjetet dhe pajisjet për të qënë më të gatshëm në raste renie zjarri

Komandant shërbimi të MZSH

▪

KREU V

**KOMISIONET E PËRHERSHME, TË PËRKOHSHME DHE
STRUKTURAT KONSULTATIVE TË BASHKISË**

NENI 107

KOMISIONI I VLERESIMIT TE OFERTAVE

Qëllimi i Komisionit të Vleresimit te Ofertave:

- Komisioni i Vleresimit te Ofertave ngrihet dhe funksionon në zbatim të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar dhe akteve të tjera nënligjore. Ngritja e tij bëhet me urdhër të Kryetarit të Bashkisë, i cili është edhe kryetari i Autoritetit Kontraktues;
- Komisioni i Vleresimit te Ofertave përgjigjet për hartimin e dokumentacionit dhe ndjekjen e procedurave të prokurimit, me qëllim prokurimin e fondeve të vëna në dispozicion nga Buxheti i
- Shtetit ose të ardhurat e Bashkisë për projekte në infrastrukturën publike, në mënyrë transparente dhe sa më efektive;

2. Kryetari i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ka për detyrë:

- Të organizojë punën e komisionit, para dhe ditën e zhvillimit të tenderit;
- Së bashku me anëtarët e tjerë të KVO-së, merr pjesë në hartimin e dokumentacionit të tenderit dhe gjatë zhvillimit të procedurave të

prokurimit;

- Ndjek hartimin e regjistrit të prokurimeve publike në fillim të vitit buxhetor;
- Ndjek dhe kontrollon punën për zbatimin e regjistrit të prokurimeve për vitin në vijim, afatet e përcaktuara dhe procedurat e prokurimit;
- Relaton në mënyrë periodike tek Kryetari i Bashkisë, mbi ecurinë e punës dhe problemet e konstatuara gjatë prokurimeve publike;
- Mban përgjegjësi për respektimin e afateve kohore të procedurave të prokurimit, njoftimin në buletin të APP-së dhe sigurimin e materialeve për plotësimin e dokumenteve të tenderit.

NENI 108

KOMISIONI I BLERJEVE TË VOGLA

Komisioni i Blerjeve të Vogla (KBV) ka si mision:

- Objekti i punës i Komisionit të Blerjeve të Vogla është të realizojë të gjitha procedurat ligjore për prokurimin e blerjeve me vlera të vogla, në përputhje me kërkesat e U d h ë z i mit nr. 1, date 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” I ndryshuar.
- Ndjek dhe përgjigjet për hartimin e dokumentacionit dhe ndjekjen e procedurave të prokurimit, për blerjet e vogla me fond limit deri në 400 mijë lekë;
- Të realizojë blerjet e vogla për plotësimin e nevojave të administratës së bashkisë, gjithnjë me efektivitet dhe transparencë.

Komisioni i Blerjeve të Vogla ka si detyrë:

- Testimin e tregut, për të përcaktuar çmimet për mallra ose shërbime, të cilat do të prokurohen në bazë të kërkesave të drejtorive brenda institucionit të Bashkisë së Divjakes;
- Me verifikimin e ofertave në treg relacion në KBV mbi çmimet e tregut për mallra dhe shërbime të ndryshme dhe mbas miratimit të këtyre të fundit kryen prokurimin përkatës;
- Mban të azhornuar listën e shoqërive të specializuara që mund të furnizojnë materiale ose shërbime sipas nevojave të institucionit, të domosdoshme për një procedurë prokurimi, duke bashkëpunur me
- organe dhe institucione të specializuara (Sektori i taksave dhe i tarifave vendore etj);
- Merr masa që malli dhe shërbimi të bëhen hyrje dhe dalje, sipas rastit, nga magazina, në përputhje me procedurat e parashikuara në ligj;
- Përgatit dokumentacionin përkatës bashkë me KBV-në mbi procedurat e ndjekura për kryerjen e një prokurimi të vogël dhe e paraqet për likuidim;
- Firmos procesverbalin e blerjeve nga gjithë anëtarët e Komisionit të Blerjeve të Vogla.

NENI 109

KOMISIONI VENDOR I EMERGJENCAVE CIVILE

Detyrat dhe kompetencat e këtij komisioni përcaktohen në ligjin nr. 8756, datë 26.3.2001 “Për Emergjencat Civile”, të trajtuara në programin vjetor të emergjencave civile.

Është komision permanent gjithëvjetor i emergjencave civile dhe ka si detyrë:

- Organizimin dhe ndjekjen e aktivitetit të KVEC, duke bashkërenduar punën

me organizatat vullnetare, forcat operacionale për planizimin dhe përballimin e emergjencave civile;

- Ndjekjen dhe koordinimin e punës me komisariatit e policisë, PMNZSH-në,

njësinë e reparteve ushtarake, ndërmarrje dhe institucione vendore, subjekte private dhe struktura të tjera, të cilat

- mundësojnë realizimin e planeve të veprimit në rast të emergjencave civile;
- Kontrollin e vazhdueshëm të gjendjes fizike të vendstrehimeve të mbrojtjes së popullatës dhe marrjen e masave për përmirësimin e gjendjes së tyre;
- Kontrollin e vazhdueshëm për zbatimin e masave të mbrojtjes nga zjarri në vetë godinën e bashkisë, institucionet dhe ndërmarrjet e vartësisë;
- Evidenton rastet e dëmeve nga zjarri, rrëshqitje toke, përmytje, dëmtime më eksploziv etj., dhe organizon punën për dhënien e ndihmës emergjente e më pas financiare të të dëmtuarve në bazë të legjislacionit në fuqi;
- Evidenton forcat operacionale, OJF-të vendase e të huaja që veprojnë në territorin e bashkisë, me qëllim angazhimin e përfshirjen e tyre në raste emergjence .

JURIST

Andi BULLARI